

OBSERVATORI I EKONOMIVE TË PALIGJSHME NË EVROPËN JUGLINDORE



BULETINI I RREZIQEVE

PËRMBLEDHJE E PIKAVE KRYESORE

1. Një qendër trafikimi në mes të askundit.

Keni dëgjuar ndonjëherë për Gornji Vakuf-Uskoplje? Ky qytet i panjohur në Bosnjë-Hercegovinën Qendrore është qendra e një kompanie kamionësh të quajtur Sičaja. Në janar 2021, drejtori i kompanisë, një biznesmen i njohur dhe me lidhje politike, u arrestua për zotërimin e 400 kilogramëve kanabis. Qyteti është bërë një pikë e rëndësishme e trafikut të drogës, gjë që tregon rëndësinë e qendrave logjistike në zinxhirët e furnizimit dhe lidhjet midis ekonomive të ligjshme dhe të paligjshme, si dhe lidhjet mes biznesit, elitave politike dhe atyre kriminale.

2. Një goditje ndaj krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor?

Në një seri arrestimesh në janar dhe shkurt 2021, policia në Serbi, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovinë ndaloi kriminelë që, sipas pretendimeve të medias, kanë lidhje me klanet famëkeqe kriminale Kavač dhe Škaljari nga Mali i Zi. Për më tepër, presidenti i Serbisë ka premtuar se do të godasë krimin e organizuar. Disa personazhe të rëndësishme janë arrestuar, por në zhvillimet e fundit janë kapur edhe disa elementë të medias dhe policisë.

3. Cenueshmëria e fëmijëve romë nga shfrytëzimi seksual tregtar.

Shfrytëzimi seksual tregtar i fëmijëve është një shqetësim serioz në të gjithë Ballkanin

Perëndimor. Fëmijët romë përbëjnë një grup veçanërisht të cënueshëm. Duke u mbështetur në informacionet nga një raport i ardhshëm i GI-TOC, ne shikojmë se pse fëmijët romë janë kaq të prekshëm dhe si shfaqet problemi, si brenda Ballkanit Perëndimor, ashtu edhe në pjesë të tjera të Evropës.

4. "Skifterët" e Kurbinit: një shkollë hajdutësh.

Në vitet e fundit, grabitjet dhe vjedhjet në shtëpitë e lojtarëve të futbollit dhe personave të famshëm kanë qenë ndër lajmet kryesore në Spanjë dhe Itali. Shumë nga autorët e krimeve janë të rinj që vijnë nga rajoni i Kurbinit, në Shqipëri. Ne shikojmë se pse kjo zonë po prodhon dhe eksporton kaq shumë hajdutë.

5. Rinia si motori i komunitetit: një intervistë me Qendrën Rinore Sebastia.

Bashkia e Kurbinit, e shtrirë rreth qytetit të Laçit, ka fituar një reputacion në Shqipëri dhe jashtë saj si një shkollë e mirënjohur për vjedhje. Ky rajon përballlet me vështirësi sociale-ekonomike, me mundësi të kufizuara për një karrierë normale për të rinjtë dhe pak organizata të shoqërisë civile (OSHC). Për të trajtuar këtë problem, një avokate e re dhe një mësues lokal u bashkuan për të krijuar Qendrën Rinore Sebastia, një organizatë që përpaket të rrëzojë stereotipet dhe t'i japë rinisë një platformë për një jetë më të mirë. Ne flasim me themeluesit dhe drejtuesit e saj, Emarilda Leti dhe Elton Laska.



RRETH KËTIJ NUMRI

Mirë se vini në numrin e gjashtë të "Buletinit të Rreziqeve" të prodhuar nga Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore i Iniciativës Globale kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC).

Ne fillojmë, si gjithmonë, me një profil të një pike të nxehtë të krimit të organizuar në rajon, këtë herë është qyteti pak i njohur Gornji Vakuf-Uskoplje në Bosnjë-Hercegovinë. Kjo qendër logjistike u shndërrua në një pikë kryesore pas konfiskimit të 400 kilogramëve kanabis kohët e fundit.

Ka pasur gjithashtu disa operacione të rëndësishme kundër krimit të organizuar në disa vende të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovinën, duke sjellë disa arrestime, përfshirë edhe drejtuesin e njohur të një grupi tifozësh futbollit në Serbi. Situata në Serbi ka pasur disa vështirësi, duke përfshirë një fushatë shpifjesh kundër një grupi gazetarësh investigativë nga disa tabloide dhe politikanë, gjë që është dënuar nga GI-TOC.

GI-TOC do të botojë së shpejti një raport të ri mbi shfrytëzimin tregtar seksual të fëmijëve (CSEC) në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Në këtë botim, ne paraqesim një aspekt të problemit, përkatësisht shfrytëzimin

e fëmijëve romë që janë veçanërisht të prekshëm nga shfrytëzimi tregtar seksual i fëmijëve (CSEC).

Hajdutët shqiptarë, të njohur si "skifterë", janë bërë të njohur gjatë viteve të fundit për kryerjen e grabitjeve dhe vjedhjeve në shtëpitë e personave të pasur dhe të famshëm, në mënyrë të veçantë të futbollistëve dhe personave të famshëm në Spanjë dhe Itali. Shumë nga "skifterët" janë nga një rajon i vogël dhe i varfër i Shqipërisë me emrin Kurbin. Ne shikojmë se pse kjo zonë po prodhon dhe eksporton kaq shumë hajdutë dhe flasim me dy drejtorë të një organizate të shoqërisë civile që punon me të rinjtë në zonë për t'i bërë ata më pak të cenueshëm nga jeta e krimit.

Si përfundim, ne paraqesim një përmbledhje të botimeve të fundit në lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin në Ballkanin Perëndimor dhe prezantojmë disa raporte të reja nga GI-TOC. Ne përqipemi ta botojmë herë pas here një listë të tillë dhe mirëpresim çdo sugjerim.

Na informoni nëse dëshironi të kontribuoni në një histori; ne ofrojmë një honorar për autorët. Nëse keni një propozim për një histori ose dëshironi të jepni komente, ju lutemi kontaktoni me adresën Kristina. Amerhauser@globalinitiative.net.

1. Një qendër trafikimi në mes të askundit.

Gornji Vakuf-Uskoplje është një qytet i vogël në Bosnjë-Hercegovinë. Fakti që është një qendër logjistike, afër autostradave kryesore, e bën atë një pikë të nxehtë me një pozicion strategjik, por megjithatë pak të dukshëm, për trafikimin.

Qyteti, me një popullsi prej rreth 20 000 banorësh,¹ është afër qytetit të Bugojnos në pjesën qendrore të vendit. Për këtë arsye, ai ndodhet afër rrugëve kryesore që shkojnë në veri-jug nga Banja Luka në Mostar dhe në lindje-perëndim nga Sarajeva në Kroaci.² Ashtu si pikat e tjera të nxehta të trafikimit, qyteti vuan nga vështirësitë sociale-ekonomike, duke përfshirë papunësinë e lartë (43,5 përqind në vitin 2016) dhe një pagë mesatare të ulët prej 345 € në muaj.³ Qyteti është i ndarë midis boshnjakëve dhe kroatëve, gjë që i ka forcuar rrjetet

e patronazhit me bazë etnike, por i ka dëmtuar institucionet publike.

Në dhjetë vitet e fundit, pozicioni i tij qendror është përdorur për të ndërtuar një mjedis kriminal në këtë lokalitet të vogël. Megjithatë, ai ka vepruar kryesisht i pazbuluar.

Një nga të paktat raste kur Gornji Vakuf-Uskoplje ka qenë në titujt e gazetave ishte kur një nga ish-banorët e tij, Vinko Žuljević Klica, u vra në maj 2015 në Zagreb. Klica, një veteran i luftës, ishte i lidhur me një prej kompanive më të fuqishme të sigurisë në Kroaci dhe pretendohet se ishte një lojtar kryesor në botën e fshehtë të Zagrebit.⁴

Por në janar 2020, Gornji Vakuf-Uskoplje ishte përsëri në titujt e lajmeve kur Ante Sičaja, pronari i një kompanie lokale import-eksporti me të njëjtin emër, u arrestua me 400 kilogramë kanabis me një vlerë të llogaritur në 2 milionë €. Kanabisi, i cili vinte nga Shqipëria dhe Mali i Zi, pretendohet se ishte transportuar nga kompania e tij nga Kapljina përmes Bilecas dhe Mostarit. Droga ishte ripaketuar në Gornji Vakuf-Uskoplje. Një pjesë e vogël u mbajt për tregun e brendshëm, ndërsa pjesa më e madhe e kanabisit u dërgua në perëndim në Kroaci dhe më tej në Bashkimin Evropian.⁵ Nga sa duket, lidhjet politike të pronarit, i cili thuhet se ka lidhje me Unionin Demokratik Kroat, bashkë me reputacionin e mirë të kompanisë në rajon, mund të kenë ndihmuar për të shmangur dyshimet.

Ka mundësi që ky operacion kundër narkotikëve, i kryer nga Agjencia Shtetërore e Hetimit dhe e Mbrojtjes, të ketë ekspozuar një rrjet që ka qenë në veprim prej një kohë të gjatë. Policia thuhet se ka gjetur një ditar personal të mbajtur nga Sičaja, i cili lidh aktivitetet e paligjshme të kompanisë me personazhe të tjera të kimit në rajon, duke përfshirë Kroacinë, Malin e Zi dhe Bullgarinë.⁶

Për më tepër, ka raste të fundit që tregojnë se blerësit vinin në Gornji Vakuf-Uskoplje për të blerë droga, të cilat thuhej se ishin më të lehta për t'u marrë dhe relativisht të lira.⁷ Konfiskimet nga qytetet në zonat përreth zakonisht arrijnë të zbulojnë se burimi i drogës është përsëri nga Gornji Vakuf-Uskoplje.⁸

Thuhet se qyteti është gjithashtu një qendër për kontrabandën e armëve. Ka pasur raste në të cilat janë konfiskuar armë nga banorët e komunës. Në ambientet e kompanisë Sičaja janë gjetur po ashtu armë.⁹

Ky rast ilustron se pikat kryesore të drogës mund të mos jenë vetëm qendrat kryesore urbane ose qytetet e prekshme nga pikëpamja sociale-ekonomike, por edhe qendra logjistike përgjatë rrugëve kryesore të trafikimit. Për shembull, në prill 2020, policia maqedonase zbuloi 1,2 ton kanabis në një depo në afërsi të Shkupit. Në nëntor 2020, policia serbe kapi 628 kilogramë kanabis në një hangar të braktisur në Arandjelovac, 80 kilometra në jug të Beogradit. Droga po paketohej për shpërndarje të mëtejshme në Evropën Perëndimore. Në nëntor 2019, policia serbe kapi 77 kilogramë heroinë afër qytetit Mladenovac në periferi të Beogradit.

Këta shembuj tregojnë se, kur shikohet fluksi i drogave, është diçka e thjeshtuar dhe jo e saktë të shënosh shigjeta në një hartë që tregon trafikimin e heroinës, për shembull, nga Turqia përmes Ballkanit Perëndimor në BE, ose të kanabisit nga Shqipëria përmes Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës në Kroaci dhe më tej si të ishin udhëtime direkte dhe të pandërprera. Realiteti është se këto dërgesa bëhen zakonisht me anë të një serie udhëtimesh të shkurtra, ku udhëtimi dhe shpesh ngarkesa ndahet për të shmangur pengesat dhe për të përfutur nga mundësitë aktuale.

Rrugët e trafikimit priren të ndjekin rrugët ku ka më pak rezistencë, ku rreziku është më i ulët për shkak të lidhjeve politike, korrupsionit dhe fshehjes në një formë relativisht të sigurt të transportit (në këtë rast, një kompani e njohur e kamionëve). Në të vërtetë, rasti i Gornji Vakuf-Uskoplje tregon lidhjet mes ekonomisë së ligjshme dhe të paligjshme dhe marrëdhëniet ndonjëherë të afërta mes biznesit, elitave politike dhe atyre kriminale.



FIGURA 1 RRUGËT E TRAFIKIMIT TË DROGËS PËRMES GORNJI VAKUF-USKOPLJE.

2. Një goditje ndaj krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor?

Në një seri arrestimesh në janar dhe shkurt 2021, policia në Serbi, Malin e Zi dhe Bosnjë-Hercegovinë ndaloi kriminelë që, sipas pretendimeve të medias, kanë lidhje me klanet famëkeqe kriminale Kavač dhe Škaljari nga Mali i Zi. Policia në Maqedoninë e Veriut arrestoi gjashtë persona në Prilep, qytetin e katërt më të madh të vendit, me akuzë në lidhje me drogat.¹⁰ A po vëmë re një goditje të krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor?

Në mëngjesin e 4 shkurtit, prokurori kundër krimit të organizuar në Serbi, Mladen Nenadić, njoftoi se policia kishte arrestuar 16 persona të dyshuar për krime të rënda.¹¹ Lajmi u përhap me shpejtësi. Disa pjesë të medias spekuluan se ky ishte fillimi i goditjes së premtuar prej kohësh nga Presidenti Aleksandër

Vučin ndaj krimit të organizuar,¹² ndërsa disa të tjerë theksuan domosdoshmërinë e hetimit të lidhjeve midis grupeve kriminale dhe zyrtarëve në politikë dhe shërbimet e sigurisë.¹³

Një nga personazhet më të rëndësishëm të arrestuar ishte Veljko Belivuk. Në fillim të viteve 2000, Belivuk ishte anëtar i Forcës së Bashkuar, një grup ultra i formuar nga fanatikët e Beogradit për të mbështetur klubin serb të futbollit FK Rad. Ai kishte punuar gjithashtu si roje sigurie në një klub nate në Beograd, ku kishte rrahur dhe plagosur dy persona në vitin 2007. Gjykata më në fund e shpalli atë fajtor tetë vjet më vonë¹⁴ Belivuk u bë i njohur për publikun në prill 2016 kur, së bashku me Aleksandar Stanković, udhëheqësin e grupit të tifozëve Janjičari të



Veljko Belivuk, udhëheqësi i një grupi serb huliganësh me lidhje me botën e krimit, u arrestua në Beograd në shkurt 2021.

Fotografi: Stefan Tomasevic&ATAImages

klubit të futbollit FK Partizani, u regjistrua nga një kamerë monitorimi duke rrahur brutalisht trupin e menaxherit të përgjithshëm të FK Partizani.¹⁵

Pasi Stanković u vra në një atentat të stilit mafioz në tetor 2016,¹⁶ Belivuk u bë pasuesi i Stanković si udhëheqësi i ri i grupit Janjičari.¹⁷ Një ditë pas vrasjes, ministri i brendshëm i asaj kohe, Nebojša Stefanović, i shpalli luftë mafies dhe policisë së korruptuar.¹⁸ Sidoqoftë, në vitet në vijim, rrugët e Serbisë u shndërruan në një fushë beteje, me më shumë se 60 vrasje që dyshohet se kishin lidhje me krimin e organizuar.¹⁹

Problemet e Belivukut me ligjin vazhduan në vitin 2017, kur ai u akuzua si bashkëpunëtor në organizimin e një vrasjeje. Sidoqoftë, gjykata e liroi atë nga akuzat.²⁰ Ndërkohë, gazetarët investigativë zbuluan disa fotografi të anëtarëve të grupit Janjičari me një zyrtar të lartë policie,²¹ si dhe lidhje të mundshme mes Belivuk dhe zyrtarëve të lartë në Ministrinë e Brendshme.²² Për më tepër, anëtarët e grupit Janjičari kishin rolin e rojeve të sigurisë në inaugurimin e Presidentit Vuçiç.²³ Sipas raportimeve, grupi Janjičari ka po ashtu lidhje me klanin Kavač.²⁴

Në Serbi, dihet se grupet e huliganëve janë të përfshira në aktivitete të paligjshme në lidhje me drogën, sigurinë private, lojërat e fatit dhe ndërtimin.²⁵ Sidoqoftë, Vuçiç ka premtuar të luftojë kundër mafies, "pavarësisht nga pasojat personale, politike dhe çdo pasojë tjetër".²⁶

Në shkurt 2021, policia serbe e arrestoi Belivuk-un pas kthimit të tij nga Mali i Zi, ku ai dyshohet se ishte takuar me Radoje Zvicer-in, një nga drejtuesit e klanit Kavač.²⁷ Grupi i Belivuk-ut akuzohej për vrasje, zhvatje, rrëmbim dhe shpërndarje droge,²⁸ si dhe për një plan të mundshëm për të vrarë një zyrtar të lartë shtetëror.²⁹ Të dyshuar të tjerë janë akuzuar për bashkëpunim në vepra penale, prodhimin dhe shpërndarjen e paautorizuar të narkotikëve, si dhe prodhimin, zotërimin, mbajtjen dhe trafikimin e paligjshëm të armëve dhe eksplozivëve, përveç tre rasteve të vrasjeve të rënda.³⁰

Në një rast tjetër, në qytetin e Tivatit në Malin e Zi, në janar policia ndaloi disa anëtarë të dyshuar të një organizate kriminale. Besohej se të dyshuarit "kishin si qëllim të eliminonin anëtarët e grupit Kavač".³¹ Një nga objektivat e planifikuara mendohej të ishte Belivuk-u.

Në shkurt, policia në Bosnjë-Hercegovinë arrestoi tre shtetas malazezë afër resortit të skive të Jahorinës për prodhim dhe trafikim të paligjshëm të drogave dhe armëve.³² Sipas raportimeve të medias, ata ishin nga klani Škaljari dhe kishin në plan të vrisnin drejtuesin e klanit rival Kavač, Radoje Zvicer-in, si dhe gruan e tij, gjatë qëndrimit të tyre në resort.³³

Përsëri në Serbi, Vuçiç premtoi se do të shfaqte fotografi të mizorive të grupit Janjičari.³⁴ Në një konferencë shtypi në mars, Vuçiç paraqiti një fotografi të një viktime pa kokë para një audience televizive në orarin më të ndjekur.³⁵ Më pas, një gazetar nga Rrjeti i Raportimit për Krimin dhe Korrupsionin (KRIK) e pyeti presidentin se pse disa nga përfaqësuesit e qeverisë nuk po merreshin në pyetje nga policia. Vuçiç nuk u përgjigj.³⁶ Disa ditë më vonë, tabloidët proqeveritarë e akuzuan rrjetin KRIK dhe disa oficerë policie se ishin pjesë e grupit Janjičari.³⁷ Shoqatat e medias dhe organizatat ndërkombëtare,³⁸ duke përfshirë GI-TOC, reagues ndaj fushatës së shpifjeve,³⁹ ashtu si dhe Vuçiç, i cili deklaroi se rrjeti KRIK duhet të lihet i qetë të bëjë punën e tij pasi kjo është demokracia.⁴⁰

Ndërkohë që nuk duket se do të ketë fund përplasja mes klaneve Škaljari dhe Kavač nga Mali i Zi që filloi në vitin 2014 dhe ka përfshirë personazhe të grupeve kriminale dhe huligane serbe,⁴¹ përpjekjet e shtetit për t'i goditur duket se janë rritur.

Serbia ka reaguar ashpër ndaj krimit të organizuar në të kaluarën, për shembull, gjatë operacionit Sabre në vitin 2008, i cili solli shpërbërjen e grupeve kryesore si klani i Zemunit, pas vrasjes së Kryeministrit Xhinxhiç. Do të jetë interesante të shihet nëse Presidenti Vuçiç mund ta mbajë premtimin e tij.



Në një fshat afër Tuzlës, në Bosnjë-Hercegovinë, ekziston një vendbanim me shumicë rome ku është raportuar për shfrytëzimin e fëmijëve për qëllime të ndryshme, duke përfshirë lypjen dhe shfrytëzimin seksual. *Fotografi: Bahrudin Bandic*

3. Cenueshmëria e fëmijëve romë nga shfrytëzimi tregtar seksual.

Shfrytëzimi tregtar seksual i fëmijëve (CSEC) është një shqetësim serioz në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Një raport i ardhshëm kërkimor nga GI-TOC, i cili pritet të botohet në prill 2021, tregon se fëmijët janë të ekspozuar ndaj formave të ndryshme dhe shpesh të shumta të shfrytëzimit. Ata shfrytëzohen më shpesh në bare dhe hotele, por ka edhe raporte të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në lëvizje dhe në hapësirën kibernetike. Ndërsa raporti i ardhshëm përqendrohet në përgjithësi në cenueshmërinë e fëmijëve nga shfrytëzimi tregtar seksual (CSEC) në internet dhe në industrinë e udhëtimit dhe turizmit, kërkimet tona në terren kanë siguruar gjithashtu njohuri në mënyrë specifike për cenueshmërinë e fëmijëve romë, të cilët janë ndër grupet më të rrezikuara në lidhje me CSEC në të gjithë rajonin.

Romët në të gjithë Ballkanin Perëndimor shpesh jetojnë në vendbanime informale ku hapësirat janë të

mbipopulluara dhe ka akses të kufizuar në shërbimet e infrastrukturës dhe kanalizimeve. Në të vërtetë, në Shqipëri, më pak se 50 përqind e të gjitha familjeve rome kanë akses për ujë të pijshëm.⁴² Formalizimi i këtyre vendbanimeve ka qenë i ngadaltë dhe shumë komunitete rome vazhdojnë të jetojnë si grupe të mbyllura, me pak akses në ekonominë formale ose shërbimet qeveritare. Në Kosovë, për shembull, vetëm 10 për qind e romëve mbi moshën 16 vjeç raportohet se kanë akses në sigurimin shëndetësor.⁴³ Ky marginalizim ka mbështetur gjithashtu vazhdimësinë e krijimit të stereotipeve rreth mënyrës së jetesës dhe kulturës, gjuhës dhe traditave të tyre, gjë që e ka bërë më të vështirë integrimin e tyre në shoqëritë lokale.

Përgjashtimi, marginalizimi dhe diskriminimi historik me të cilët janë përballur romët kanë sjellë nivele të ulëta arsimimi dhe papunësi të lartë. Vetëm një përqindje

e vogël e fëmijëve kanë akses të rregullt në arsim. Shkalla e regjistrimeve në arsimin fillor dhe parashkollor është veçanërisht shqetësuese. Në Serbi, arsimi parashkollor mbulon më pak se 4 për qind të romëve, ndërsa në Bosnjë-Hercegovinë, vetëm 2 për qind të fëmijëve romë të moshës tre deri në pesë vjeç janë regjistruar në programet arsimore.⁴⁴ Shkalla e punësimit varion nga 11 për qind në Bosnjë-Hercegovinë deri në 22 përqind në Maqedoninë e Veriut (me pjesën tjetër të vendeve të Ballkanit Perëndimor që ndodhen ndërmjet këtyre treguesve).⁴⁵

Këta faktorë, ndër të tjera, i bëjnë të rriturit romë, si dhe fëmijët e tyre, të cënueshëm nga forma të ndryshme të shfrytëzimit. Në mënyrë më të dukshme, disa raporte kanë studiuar rolin e fëmijëve romë për të lypur me detyrim në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropën Perëndimore.⁴⁶ Fëmijët romë dyshohet se detyrohen të lypin në shumicën e qyteteve të mëdha dhe në kryeqytetet e rajonit. Fëmijët romë raportohet gjithashtu se trafikohen në qytetet bregdetare dhe zonat turistike

Çështja e "Hamidoviç"

Në vitin 2015, agjencitë franceze të zbatimit të ligjit në bashkëpunim me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin me Drejtësinë Penale filluan një hetim ndaj Husmet Hamidoviç, i cili dyshohej se drejtonte një rrjet ndërkombëtar të organizuar të trafikimit njerëzor. Hamidoviç, një shtetas boshnjak, u shpall fajtor për trafikimin e më shumë se 500 vajzave dhe grave rome kryesisht nga Bosnjë-Hercegovina në Francë për qëllimet e shfrytëzimit seksual, lypjes dhe vjedhjes së xhepave. 22 vajza të tjera që i përkisnin rrjetit të tij u gjetën në një shtëpi në Zenicë, në Bosnjë-Hercegovinë. Rrjeti ishte gjithashtu aktiv në Austri, Belgjikë, Itali dhe Spanjë.

Shumë vajza ishin detyruar të martoheshin me anëtarët e rrjeteve kriminale për ta bërë më të lehtë udhëtimin e tyre mes Bosnje-Herzegovinës dhe Francës. Vizat e falsifikuara merreshin me emra të rremë kryesisht nga Ambasada Boshnjake në Paris, e cila merrte nga 500 deri në 1200 € për çdo dokument. Vajzat raportohet se kanë udhëtuar rregullisht midis dy vendeve pasi kishin për detyrë të sillnin paratë përsëri në Ballkanin Perëndimor.

dhe, ndonjëherë, detyrohen të bëhen objekt i shfrytëzimit seksual, sidomos për aktivitete seksuale në bare, restorante dhe hotele.⁴⁷

Siç përshkruhet në raportin e ardhshëm kërkimor, një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve romë detyrohen të martohen nga anëtarët e afërt të familjes ose njerëz me ndikim në komunitet. Megjithatë të dhënat janë natyrshëm të vështira për t'u gjetur dhe për t'u marrë, raportet e mëparshme kanë argumentuar se në Maqedoninë e Veriut më shumë se 22 përqind e të gjitha vajzave rome të moshës 15-19 vjeç janë detyruar të martohen, ndërsa shifra për Kosovën është 10 për qind. Në Bosnjë-Hercegovinë, 50 për qind e të gjitha grave rome martohen para moshës 18 vjeç, një shifër që ka shumë gjasa të mos paraqesë dinamikën reale.

Vajzat (dhe në një masë më të vogël, djemtë) e moshës 10-16 vjeç⁴⁸ shiten për martesë me burra në të njëjtin komunitet ose në komunitetet rome në vendet fqinje.⁴⁹ Megjithatë shumë nga këto martesë bëhen brenda komunitetit më të gjerë rom, ekspertët thonë se martesat e detyruara mund të jenë gjithashtu fillimi i një jete në shfrytëzim, e cila përfshin detyra që variojnë nga lypja dhe vjedhja e xhepave e deri tek aktiviteti seksual në bare dhe klube nate.⁵⁰

Kompensimi monetar për vajzat e detyruara të martohen brenda komunitetit të tyre ose brenda komuniteteve të tjera në Ballkanin Perëndimor mund të jetë i ulët, duke filluar nga 200 deri në 500 €. Sidoqoftë, transaksione të tilla nuk janë gjithmonë në formën e parave, pasi ka edhe raporte për familje që i shesin vajzat e tyre për pajisje si televizor me ngjyra, frigorifer të përdorur ose makinë të përdorur.⁵¹ Sidoqoftë, më shumë para mund të fitohen duke i shitur fëmijët jashtë shtetit, sidomos në komunitetet rome në Evropën Perëndimore. Familjet mashtrohen që t'i dërgojnë fëmijët e tyre jashtë vendit me shpresën e një jete më të mirë për ta (dhe ata vetë), por mund të mos jenë të vetëdijshëm për pasojat.

Në të vërtetë, sipas ekspertëve të intervistuar në dhjetor 2020, shumë prej fëmijëve që detyrohen të martohen jashtë vendit në fakt u shiten anëtarëve të grupeve të organizuara kriminale dhe detyrohen të bëjnë punë të organizuar seksuale në të gjithë Evropën Perëndimore.⁵² Kjo u zbulua veçanërisht në të ashtuquajturën "çështja Hamidoviç" në vitin 2015, ku autoritetet franceze dhe boshnjake zbuluan më shumë se 500 vajza dhe gra rome

të trafikuar nga Bosnjë-Hercegovina në Francë dhe të detyruara të vidhnin xhepa dhe të përfshihen në punë seksuale.⁵³

Ekzistojnë pak statistika zyrtare në të gjithë Evropën Perëndimore për shfrytëzimin tregtar seksual të fëmijëve (CSEC) në përgjithësi ose për fëmijët romë si viktimë të trafikimit njerëzor për shfrytëzimin seksual në veçanti. Sidoqoftë, çështja Hamidoviç nuk ishte e vetmja që tërhoqi vëmendjen e medias dhe të gjyqësorit në vitet e fundit. Operacioni Golf, një operacion i përbashkët mes Shërbimit Policor Metropolitan të Londrës dhe Policisë Kombëtare Rumune nga viti 2007 deri në 2010, identifikoi më shumë se 1000 fëmijë romë nga një qytet rumun që ishin trafikuar në Evropën Perëndimore për punë të detyruar dhe shfrytëzim seksual.⁵⁴ Hetimet e kryera në Austri identifikuan 91 fëmijë viktimë të mundshme të shfrytëzimit seksual në vitin 2016, 73 prej të cilëve nga Bosnjë-Hercegovina, shumica e të cilëve dyshohej se ishin romë.⁵⁵ Në mënyrë të ngjashme, raporti i trafikimit njerëzor i Shteteve të Bashkuara i vitit 2020 nënvizon cenueshmërinë e fëmijëve romë të trafikuar për shfrytëzim seksual në vende të ndryshme të Evropës Perëndimore, duke përfshirë Francën dhe Gjermaninë.⁵⁶

Pavarësisht këtyre rasteve, ka ende një ndërgjegjësim të ulët për shfrytëzimin tregtar seksual të fëmijëve

në Ballkanin Perëndimor, lidhjet e tij me krimin e organizuar dhe cenueshmërinë e komunitetit rom ndaj këtij fenomeni. Raporti i ardhshëm kërkimor përpiqet të mbyllë këtë boshllëk duke siguruar një pasqyrë ndër-rajonale për këtë temë. Për shembull, në të zbulohet se si martesat e detyruara shpesh konsiderohen si tradicionale në komunitetin rom dhe, për këtë arsye, nuk hetohen dhe ndiqen si raste të trafikimit njerëzor nga autoritetet përgjegjëse. Romët nuk njihen si pakica në të gjitha vendet dhe shumë martesa dhe lindjet nuk regjistrohen, duke e bërë të vështirë për komunitetin që të marrin dokumentet dhe mbështetjen institucionale të nevojshme në vendbanimin e tyre.

Ka shumë gjëra që duhet dhe mund të bëhen për të dalluar më mirë cenueshmërinë e fëmijëve romë në të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe për të parandaluar në radhë të parë shfrytëzimin tregtar seksual të tyre (CSEC) në rajon. Kjo përfshin, ndër iniciativë të tjera, nevojën për më shumë sensibilizim, hapjen e mekanizmave kombëtarë të referimit për komunitetin rom dhe sigurimin e trajnimit të specializuar për zbatimin e ligjit dhe gjyqësorin. Paketa e plotë e rekomandimeve dhe hapave përpara u diskutua në një takim me një grup ekspertësh në 11 dhe 12 mars 2021 dhe do të paraqiten në raport.

4. "Skifterët" e Kurbinit: një shkollë hajdutësh.

Në vitet e fundit, grabitjet dhe vjedhjet në shtëpitë e lojtarëve të futbollit dhe personave të famshëm kanë qenë ndër lajmet kryesore në Spanjë dhe Itali. Shumë nga autorët e krimeve janë të rinj që vijnë nga i njëjti rajon, nga rajoni i Kurbinit në Shqipëri.

Kurbini është një bashki 50 kilometra në veri të Tiranës, kryeqytetit shqiptar. Ai kufizohet me detin Adriatik në perëndim. Gjatë periudhës komuniste, qyteti kryesor i Laçit, dikur një zonë rurale, u zhvillua dhe u shndërrua në një qendër të rëndësishme për industrinë. Si rezultat i kësaj, Laçi u rendit si qyteti i dytë më i rëndësishëm në veri të Shqipërisë për nga madhësia, popullsia dhe rëndësia ekonomike.⁵⁷

Sidoqoftë, me rënien e komunizmit në fillim të viteve 1990, fabrikat u mbyllën. Papunësia u rrit dhe shumë njerëz emigruan në Greqi dhe Itali për të kërkuar punë. Kjo bashki

u godit gjithashtu rëndë nga trazirat civile që përfshinë Shqipërinë në vitin 1997, pas shembjes së skemave piramidale. Dhuna la pas një trashëgimi kriminaliteti, armësh dhe një kulture paligjshmërie.⁵⁸ Ky u shndërrua në një mjedis ku të rinjtë i drejtoheshin jetës së krimit.

Të rinjtë nga Kurbini morën reputacionin se ishin hajdutë të aftë, duke grabitur vila dhe makina luksoze në Evropën Perëndimore. Ata tërhoqën vëmendjen e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe mediave në Milano dhe Torino pasi grabitën disa personazhe të famshme, duke përfshirë futbollistë.⁵⁹ Liberalizimi i udhëtimeve brenda zonës Shengen në vitin 2010 krijoi mundësi më të mëdha për shqiptarët për të udhëtuar.⁶⁰ Hajdutët nga Kurbini e shfrytëzuan këtë mundësi për ta zgjeruar shtrirjen e tyre në Andorrë, Belgjikë, Francë, Luksemburg, Holandë, Spanjë dhe Zvicër.



Kurbini, një qytet në Shqipëri i goditur rëndë nga papunësia dhe dhuna, është bërë një terren i përshtatshëm për përgatitjen e hajdutëve.

Fotografi: Desarta Mejdini

Të rinjtë që ktheheshin nga "aventurat" e tyre jashtë vendit me makina të shtrenjta, veshje dhe stoli u bënë model për fëmijët e varfër dhe lehtësisht të ndikueshëm në Kurbin që dëshironin të ishin po aq "të suksesshëm" sa heronjtë e tyre të rinj.⁶¹ Në vitin 2015 dhe 2016, fenomeni u përhap aq shumë në këtë zonë sa disa të rinj braktisën shkollën në mënyrë që të udhëtonin jashtë vendit dhe të merreshin me vjedhje. Të rinjtë me përvojë në vjedhje me thyerje të banesave i transmetuan aftësitë e tyre te më të rinjtë në një mënyrë që u bë faktikisht një shkollë krimi. Nga ky terren rekrutimi, ekipet mbledheshin dhe përhapeshin në të gjithë Evropën për kryerjen e grabitjeve.

Vjedhjet e profilit të lartë të vilave të futbollistëve të famshëm nga klubet spanjolle si Real i Madridit dhe Barcelona rritën më tej mitin e hajdutëve nga Kurbini.⁶² Media i quajti ata 'skifterë' për aftësitë e tyre të shpejta dhe grabitqare. Hajdutët u bënë pjesë e kulturës popullore shqiptare, me shfaqje televizive dhe filma

që përshkruajnë, dhe nganjëherë satirizojnë, mënyrat e jetës grabitqare dhe luksoze të të rinjve nga Laçi.⁶³ Sidoqoftë, aspektet më pak magjepsëse të skifterëve kanë tërhequr më pak vëmendje, si p.sh. të rinj të vrarë në ndjekje makinash me policinë ose të mbetur invalidë pas rënies nga lartësitë gjatë grabitjeve.⁶⁴

Pavarësisht nga vëmendja e lartë mediatike që i është dhënë problemit, pak është bërë për ta trajtuar atë. Kurbini mbetet një nga zonat më të varfra të Shqipërisë me nivele të larta të papunësisë, sidomos te të rinjtë.⁶⁵ Situata u përkeqësua më tej nga tërmeti i nëntorit 2019 që shkatërroi pothuajse gjysmën e të gjitha ndërtesave në Laç.⁶⁶ Epidemia e COVID-19 i ka thelluar më tej dobësitë ekonomike.

Disa nga iniciativat e pakta që janë bërë për t'u dhënë rrugë alternative të rinjve nga Kurbini kanë ardhur nga grupet e shoqërisë civile si Qendra Rinore Sebastia, e profilizuar më poshtë.

5. Rinia si motori i komunitetit: një intervistë me Qendrën Rinore Sebastia.



Bashkia e Kurbinit ka fituar një reputacion në Shqipëri dhe jashtë saj si një shkollë e njohur për vjedhjet. Ky rajon përballlet me vështirësi sociale-ekonomike, ka mundësi të kufizuara për një karrierë normale për të rinjtë dhe pak organizata të shoqërisë civile (OSHC). Për të trajtuar këtë problem, një avokate e re dhe një mësues lokal u bashkuan për të krijuar Qendrën Rinore Sebastia, një OSHC që përpiqet të rrëzojë stereotipet dhe t'i japë rinisë një platformë për një jetë më të mirë. Ne flasim me themeluesit dhe drejtuesit e saj, [Elton Laska](#) dhe [Emarilda Leti](#).

Çfarë mund të na thoni për qendrën Sebastia dhe punën që po bëni në Kurbin?

Qendra Sebastia u krijua në 2013 nga Elton Laska. Në bashkëpunim me një organizatë zvicerane, Sebastia u aktivizua për sigurimin e pajisjeve shkollore për fëmijët në Laç, por ky ishte një angazhim afatshkurtër. Në vitin 2019, ne të dy po punonim së bashku në një projekt për organizatën Caritas për Shqipërinë, i cili ishte përqendruar në sigurimin e punësimit për të rinjtë në zonë. Kur mbaroi ai projekt, ne menduam se kishte ende shumë për të bërë për të mbështetur të rinjtë në Kurbin. Kështu që ne vendosëm të rifillojmë qendrën Sebastia.

Ne filluam të organizojmë aktivitete kulturore dhe sociale për të rinjtë mbi baza vullnetare. Një nga iniciativat tona të para ishte një seri aktivitetesh për të prezantuar modele. Ne ftuam njerëz të shquar nga komuniteti që të vinin dhe t'u flisnin të rinjve për t'i frymëzuar dhe për t'i inkurajuar ata të ndiqnin hapat e tyre.

Për fat të keq, kjo seri nuk zgjati shumë, sepse Shqipëria u godit nga një tërmet shkatërrues në nëntor 2019, i cili i bëri gati gjysmën e ndërtesave në Kurbin të pabanueshme. Kështu që ne shpejt e zhvendosëm aktivitetin tonë drejt vullnetarizmit humanitar. Ekipi ynë i të rinjve ndihmoi në shpërndarjen e ushqimit

dhe sigurimin e strehimit të sigurt për familjet, duke bashkëpunuar ngushtë me kishën katolike në Laç.

